



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 4308 prot.

Ballsh më, 20 08 .2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 43 Datë 20 08 / 2026

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË INVESTIMIT NDËRMJET FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË MALLAKASTËR ME OBJEKT “NXITJA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NËPËRMJET APLIKIMIT TË MODELEVE INOVATIVE PËR PËRSIRËSIMIN E SHËRBIMEVE UTILITARE (FAZA II), IMPIANT FOTOVOLTAIK ME FUQI 123.72 KWP NË GODINËN DHE PARKIMIN E BASHKISË MALLAKASTËR, DHE IMPIANT FOTOVOLTAIK 286.125 KWP NË GJIMNAZIN DERVISH HEKALI, BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR”

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, marrëveshjes së investimit nr. 2047/2 datë 22.05.2026 ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër për objektin “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (Faza II), impiant fotovoltaik me fuqi 123.72 kWp në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe impiant fotovoltaik 286.125 kWp në Gjimnazin Dervish Hekali, Ballsh, Bashkia Mallakastër”,

PROPOZOJ

I. Miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër për objektin “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (Faza II), impiant fotovoltaik me fuqi 123.72 kWp në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe impiant fotovoltaik 286.125 kWp në Gjimnazin Dervish Hekali, Ballsh, Bashkia Mallakastër”,

II. Ky projekt -vendim shoqërohet me marrëveshjen e investimit bashkëlidhur.

Konceptoi: Juristi A.Heqimaj
Pranoi: Përgj, N.Sakaj
Miratoi: Drejtor M.Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj



MARRËVESHJE INVESTIMI

ndërmjet

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Bashkisë Mallakastër

për

Objektin:

“Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (FAZA II), Impiant fotovoltaiik me fuqi 123.72 kWp në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe Impiant fotovoltaiik 286.125 kWp në Gjimnazin "Dervish Hekali", Ballsh" Bashkia Mallakastër”

TIRANË2026

Tabela e Përmbajtjes

Marrëveshje Investimi	3
Objekti i Marrëveshjes	3
Detyrimet e KQT	3
Detyrimet e FSHZH	4
Realizimi i punimeve	5
Dorëzimi i objektit	5
Zgjidhja e Marrëveshjes para afatit të përfundimit të saj	6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	7
Komunikimi	7
Hyrja në fuqi	7

MARRËVESHJE INVESTIMI

Kjo Marrëveshje Investimi (MI), lidhet sot me datë 2005.2026 ndërmjet:

Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), përfaqësuar nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv,

dhe

Bashkisë Mallakastër, përfaqësuar nga Z. Qerim Ismailaj, Kryetar i Bashkisë.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Objekti i kësaj Marrëveshje është financimi i punimeve për realizimin e objektit: "Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (FAZA II), Impiant fotovoltaiik me fuqi 123.72 kWp në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe Impiant fotovoltaiik 286.125 kWp në Gjmnazin "Dervish Hekali", Ballsh" Bashkia Mallakastër", duke vendosur detyrime konkrete siç përcaktohen në nenet vijuese të kësaj Marrëveshje.
 - (i) për sigurimin e Lejes së Ndërtimit;
 - (ii) për sigurimin e lejeve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit;
 - (iii) për përfundimin e çdo procedure shpronësimi për interes publik duke siguruar financimin e plotë të kostove përkatëse të shpronësimit;
 - (iv) për mirëmbajtjen pas realizimit të objektit.
- 1.2 Ky projekt financohet nga Buxheti i Shtetit, i miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të FSHZH-së ("Ndërhyrje për ngritjen e modeleve të qëndrueshme SMECO në zona urbane me potenciale zhvillimi: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (Faza II)"), si dhe konfirmuar nga Ministria e Financave.
- 1.3 Projekti është aplikuar për financim nga Bashkia në kuadër të thirrjes për shprehje interesi.
- 1.5 Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjencia e zbatimit të projektit.

Neni 2

Detyrimet e Bashkisë

Bashkia duhet:

- 2.1 Të miratojë projektin për ndërhyrjen e propozuar, objekt i kësaj marrëveshje.
- 2.2 Të garantojë se nuk ka konflikt juridik dhe/ose social që lind nga pronësia mbi sheshin e ndërtimit ku do të zbatohet projekti.
- 2.3 Të sigurojë që tarraca/sheshi i ndërtimit ku do të vendosen panelet fotovoltaike plotëson të gjitha kushtet teknike të sigurisë, stabilitetit dhe aftësisë mbajtëse të strukturës, në përputhje me standardet dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- 2.4 Të marrë përsipër përgjegjësinë për trajtimin dhe zgjidhjen e çdo pretendimi juridik apo administrativ që lidhet me pronësinë, administrimin ose përdorimin e sheshit ku zbatohet projekti dhe çdo lloj problemi tjetër të mundshëm që pengon zbatimin e punimeve.
- 2.5 Të sigurojë të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme për zbatimin e projektit, përfshirë deklaratën paraprake të punimeve, në zbatim të nenit 7, pika 3, germa "ii", të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi.
- 2.6 Të dorëzojë sheshin e ndërtimit të projektit firmës zbatuese të punimeve brenda një afati prej 5 ditësh pas nënshkrimit të kontratës me firmën zbatuese të punimeve.
- 2.7 Të monitorojë zbatimin e projektit, konform legjislacionit në fuqi.
- 2.8 Të shkëmbejë informacion, në kuadër të kësaj marrëveshje, me FSHZH dhe mbikëqyrësin e punimeve me qëllim mbarëvajtjen e këtij projekti.
- 2.9 Të marrë përsipër mirëmbajtjen dhe funksionimin e projektit pas marrjes së përkohshme dhe përfundimtare në dorëzim të punimeve, në përputhje me standardet e pranuar.

Neni 3 Detyrimet e FSHZH

FSHZH merr përsipër:

- 3.1 Të financojë punimet për zbatimin e projektit pas nënshkrimit së kësaj Marrëveshje, sipas kontratës së nënshkruar midis FSHZH dhe Operatorit/Operatorëve ekonomikë.
- 3.2 Të kryejë prokurimin e punimeve, shërbimeve të mbikëqyrjes dhe kolaudit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.3 Të financojë kostot për mbikëqyrjes dhe kolaudimin e punimeve, sipas kontratave përkatëse të nënshkruara me operatorët ekonomikë.
- 3.4 Të fillojë zbatimin e punimeve menjëherë pas marrjes së miratimit dhe lejeve përkatëse.
- 3.5 Të ndjekë realizimin e projektit në përputhje me standardet teknike, mjedisore, sociale dhe financiare.
- 3.6 T'i dorëzojë bashkisë projektin e zbatuar sipas faktit pas përfundimit të punimeve (dorëzim i përkohshëm), si dhe pas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve (dorëzim përfundimtar), në përputhje me procedurat e marrjes në dorëzim të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4 Realizimi i punimeve

- 4.1 Projekti i përcaktuar në pikën 1.1 të nenit 1, konsiston në emërtimin: "Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike (FAZA II), Impiant fotovoltai me fuqi 123.72 kWp në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe Impiant fotovoltai 286.125 kWp në Gjimnazin "Dervish Hekali", Ballsh" Bashkia Mallakastër.
- 4.2 Këto punime do të realizohen në përputhje të plotë me projektin teknik të zbatimit.

- 4.3 FSHZH ka të drejtë të miratojë ndryshimet nga projekti fillestar i zbatimit vetëm pasi Mbikqyrësi e kërkon zyrtarisht këtë ndryshim. Në të tilla raste Mbikqyrësi paraqet dokumentacionin e plotë teknik i cili justifikon ndryshimet e propozuara.
- 4.4 Projekti do të zbatohet në përputhje me periudhën e përcaktuar në kushtet e Kontratës së Punimeve.
- 4.5 Bashkia ka të drejtë të inspektojë punimet gjatë gjithë periudhës së realizimit të tyre. Çdo vërejtje objektive nga Bashkia do të merret në konsideratë gjatë periudhës së zbatimit të projektit, deri në momentin e kolaudimit të tij. Pas kësaj periudhe vërejtjet quhen të ezauaruara edhe nëqoftëse nuk janë bërë.

Neni 5

Dorëzimi i objektit

- 5.1 Pas njoftimit zyrtar nga mbikëqyrësi për përfundimin e punimeve brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditë dorëzohet dosja teknike e objektit të zbatuar në dy kopje në FSHZH. FSHZH, një kopje të dosjes teknike të objektit të zbatuar, ia dërgon zyrtarisht Bashkisë.
- 5.2 FSHZH i vë në dispozicion Kolaudatorit dosjen teknike të objektit të zbatuar për të kryer kolaudimin e punimeve të këtij objekti që finalizohet me Aktin e Kolaudimit.
- 5.3 FSHZH cakton gjithashtu datën e inspektimit në terren dhe njofton zyrtarisht bashkinë, Kontraktorin dhe Mbikëqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim të Përkohshëm të këtij objekti. Njoftimi bëhet minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike para kryerjes së Aktit të Kolaudimit dhe përkon me datën e kolaudimit.
- 5.4. Në rastin kur Bashkia, në afatin e caktuar në pikën 5.3, për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektim/kontroll dhe refuzon nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes së Përkohshme në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim, atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim të përkohshëm nga Bashkia dhe kjo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme.
- 5.5 Periudha e Garancisë së punimeve të objektit do të jetë sipas afatit të përcaktuar në kontratën e zbatimit të punimeve dhe do të fillojë nga data e kryerjes së Aktit të Kolaudimit.
- 5.6 Bashkia ka të drejtë të njoftojë FSHZH për çdo problematikë apo defekt që mund të konstatojë gjatë gjithë periudhës së garancisë së punimeve.
- 5.7 Minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përfundimit të Periudhës së Garancisë së Punimeve, FSHZH njofton zyrtarisht bashkinë, Kontraktorin, Kolaudatorin dhe Mbikëqyrësin e Punimeve për të kryer inspektimin (kontrollin) në objekt me qëllim Marrjen në Dorëzim Përfundimtar të këtij objekti. Nëse konfirmohet se nuk ka defekte ose/dhe defektet janë riparuar, do të firmoset Certifikata e Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të Punimeve, të cilës i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor i zbatimit të objektit.
- 5.8 Në rastin kur Bashkia, në afatin e caktuar në pikën 5.7, për realizimin e inspektimit (kontrollit) në terren nuk merr pjesë në inspektimin/kontrollin e përcaktuar dhe refuzon nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim pa dhënë arsye objektive me shkrim,

atëherë objekti do të quhet i marrë në dorëzim përfundimtar nga Bashkia dhe kjo certifikatë do të konsiderohet e vlefshme.

- 5.9 Me nënshkrimin e Certifikatës së Marrjes Përfundimtare në Dorëzim të cilës i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor i zbatimit të objektit, pavarësisht se Bashkia nuk mund të jetë e pranishme, objekti kalon zyrtarisht nën administrimin dhe inventarin e bashkisë e cila ndjek dhe procedurat për pasqyrimin dhe regjistrimin e asetit (të objektit të dorëzuar) sipas kërkesave të ligjit shqiptar.

Neni 6

Dispozita të Mirëmbajtjes dhe Qëndrueshmërisë

- 6.1 Pas përfundimit të procedurës së marrjes në dorëzim, projekti kalon në administrimin dhe përgjegjësinë e Bashkisë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tij, ndërkohë që kontraktuesi mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin vetëm nga garancia.
- 6.2 Bashkia merr përsipër që nga kjo datë, të hartojë dhe zbatojë Planin e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes së projektit, si dhe të sigurojë realizimin e tij nëpërmjet kontraktimit të një subjekti të specializuar ose nëpërmjet angazhimit të strukturave përkatëse brenda institucionit në përputhje me manualet teknike dhe standardet në fuqi.
- 6.3 Bashkia garanton përfshirjen në buxhetin e saj vjetor dhe sigurimin e fondeve të nevojshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e projektit, në përputhje me Planin e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes.
- 6.4 Bashkia informon me shkrim FSHZH-në mbi zbatimin e Planit të Funksionimit dhe Mirëmbajtjes, sipas kërkesave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Zgjidhja e Marrëveshjes para përfundimit të afatit të saj

Në rast të pezullimit apo anulimit të fondeve nga Buxheti, me të cilat financohet ky projekt, do të pezullohen apo anulohen sipas rastit edhe financimi i këtij investimi nga FSHZH dhe kjo Marrëveshje do të zgjidhet pa penaltete.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 8.1 Bashkia dhe FSHZH do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata direkte në takime dhe biseda verbale çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të kenë midis tyre për çfarë lidhet me këtë Marrëveshje.
- 8.2 Nëse pas tridhjetë ditësh nga fillimi i negociatave informale konflikti nuk zgjidhet, mund të angazhohet një palë e tretë e pavarur për ndërmjetësim (p.sh. Prefekti i Qarkut), për zgjidhjen e tij. Në rast se edhe pas këtyre negociatave, konflikti nuk zgjidhet, palët do t'i drejtohen Gjykatës e cila ka kompetencën territoriale dhe lëndore për zgjidhjen e tij.

- 8.3 Palët e kësaj Marrëveshje njohin dhe pranojnë që çdo gjykim do të bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kërkesat e kësaj Marrëveshje.


Neni 9
Komunikimi

- 9.1 Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.
9.2 Një njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të ketë mbërritur në destinacionin e tij.

Neni 10
Hyrja në fuqi

- 10.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.
10.2 Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe përbëhet nga 4 (katër) kopje gjithsej, 2 (dy) kopje për FSHZH dhe 2 (dy) kopje për bashkinë.

Drejtori Ekzekutiv i FSHZH



Kryetari i Bashkisë Mallakastër

